



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

**Kodi i lëndës: INF 220**  
**Lënda: Sëmundje brendshme I**

PROGRAMI I LËNDËS Sëmundje brendshme I									
<b>Titullari i lëndës:</b>		<b>Fejzi Alushi</b> <i>Dr. shkencash në Mjekës Klinike</i> _____							
<b>Ngarkesa:</b>	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	0	0	60	1	106	94	200
<b>Tipologjia e lëndës</b>		Lëndë karakterizuese							
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>		Viti II, Semestri I							
<b>Lloji i lëndës</b>		E detyruar							
<b>Programi i studimit</b>		Bachelor në "Infermieri Mami"							
<b>Kodi i lëndës</b>		INF 220							
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>		<a href="mailto:fejzi.alushi@univlora.edu.al">fejzi.alushi@univlora.edu.al</a>							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në këtë modul përfshihen patologjitë kryesore të sistemit kardio-vaskular, pneumologjike, reumatologjike dhe njohuri mbi geriartinë. Gjatë këtij kursi studentët do të mësojnë të njohin klinikisht sëmundjet më të shpeshta të këtyre aparateve, të adresojnë menaxhimin e tyre dhe të ndërtojnë promocionin shëndetësor për to.
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Njohja e studentëve me sëmundjet e aparatit kardiovaskular, patologjitë reumatizmale, patologjitë e aparatit respirator si dhe patologjitë në moshat geriartrike.</li><li>Njohja e studentëve me kujdesin infermieror dhe asistencën ndaj pacientëve në këtë grup patologjish.</li><li>Njohja e studentëve me procedurat dhe ekzaminimet që aplikohen tek këto grupe patologjish.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>Të ndërtojnë plane kujdesi ndaj pacientëve me patologji kardiake, respiratore dhe reumatizmale.</li><li>Të përcaktojnë problematikat kryesore që lidhen me geriartinë që së fundmi po bëhet degë e rëndësishme e mjekësisë.</li></ul>

**KONCEPTET THEMELORE**

1. Aparati kardio-vaskular si një nga aparatet më të rëndësishme të trupit të njeriut dhe roli i njohjes së patologjive kardiake si një pikë kyç në diagnostikim e trajtim.



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

2. Veset kardiake dhe roli i asistencës infermierore në menaxhimin e pacientëve të diagnostikuar me këto vese kardiake.
3. Njohja me patologjitë alergjike dhe mënyra e trajtimit të tyre.
4. Sistemi respirator dhe menaxhimi i duhur i patologjive të tij mund të jetë vendimtar për jetën e pacientit
5. Geriartria dhe roli i madh që po merr kjo fushë për menaxhimin e drejtë të të gjithë personave të moshës së tretë.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p><b>Tema 1</b> - Ekzaminimi i të sëmurit, të dhënat objektive, të dhënat subjektive, ekzaminimi instrumental në kardiologji.  <i>Ekzaminimi objektiv dhe subjektiv i pacientit janë pika të rëndësishme drejt një diagnoze të saktë dhe për pasojë trajtimi të duhur të pacientit. Njohja memetodat kryesore diagnostikuese për sëmundjet e aparatit kardio-vaskular.</i></p>	<i>fq 11-27</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 2</b> - Sëmundjet e aparatit valvular, stenoza mitrale, insuficienca mitrale.  <i>Etiologjia e stenozës mitrale, simptomat klinike, metodat diagnostikuese dhe ato trajtuese. Roli i asistencës infermierore në këtë patologji.</i></p>	<i>fq 27-29</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 3</b> - Prolapsi i valvulës mitrale, stenoza e aortës.  <i>Etiologjia e prolapsit të valvulës mitrale dhe stenozës aortale, simptomat klinike, metodat diagnostikuese dhe ato trajtuese. Roli i asistencës infermierore në këto patologji.</i></p>	<i>fq 33-37</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4orë</i>
II.	<p><b>Tema 4</b> – Regurgitacioni aortal.  <i>Etiologjia e stenozës mitrale, simptomat klinike, metodat diagnostikuese dhe ato trajtuese. Roli i asistencës infermierore në këtë patologji.</i></p>	<i>fq 38-40</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 5</b> - Kardiomiopati.  <i>Klasifikimi i kardiomiopative në KMP kongjeste, hipertrofike, restriktive. Etiologjia, simptomat klinike dhe trajtimi. Kujdesi infermieristik në pacientët me kardiomiopati.</i></p>	<i>fq 52-54</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 6</b> - Sëmundjet e lindura të zemrës. Tetrada Fallot.  <i>Klasifikimi i kardiopative kongenitale, diagnoza e tyre, trajtimi dhe roli i infermierit në kujdesin ndaj pacientëve me vese të lindura të zemrës.</i></p>	<i>fq 55-58</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
III.	<p><b>Tema 7</b> - Endokarditi infektiv  <i>Endokarditi bakterial subakut dhe klinika që manifestojnë pacientët e sëmurë me këtë patologji. Mjekimi kompleks i endokarditit dhe roli i infermierit në kujdesin ndaj pacientëve.</i></p>	<i>fq 41-44</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 8</b> - Sëmundja iskemike e zemrës. Ateroskleroza.  <i>Të dhëna të përgjithshme mbi mekanizmat dhe faktorët e riskut tëaterosklerozës. Klinika në këtë patologji dhe mënyra e trajtimit. Roli i infermierit në kujdesin ndaj pacientëve.</i></p>	<i>fq 59-64</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 9</b> - Angina pectoris  <i>Etiopatogjeneza e AP, klinika që manifeston pacienti me këtë patologji,</i></p>	<i>fq 65-70</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies	
	<p><i>klasifikimi i angina pectoris dhe metodat diagnostikuese. Roli i koronarografisë. Si trajtohet SIZ dhe kujdesi infermieror në këta pacientë.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>		<i>Praktikë 4 orë</i>	
IV.	<p><b>Tema 10 -</b> Infarkti akut i miokardit <i>Sindromë klinike si pasojë e anoksisë akute të miokardit, nga ndërprerja e fluksit të gjakut në atë sektor. Etiologjia e IAM, klinika që shfaq pacienti në këtë rast, veçoritë e dhimbjes së gjoksit në IAM. Mënyra e diagnostikimit dhe kriteret diagnostike. Si trajohen pacientët me IAM dhe ndërlikimet që shfaqen.</i></p> <p><b>Tema 11 -</b> Hipertensioni Arterial. HTA <i>Klasifikimi i HTA, patogjeneza e tij dhe faktorët e riskut për shfaqjen e hipertensionit arteriale, simptomat klinike dhe ndërlikimet e mundshme. Si trajtohet pacienti me HTA. Kriza hipertensive dhe kujdesi infermieristik në të sëmurët me HTA. Teknika e matjes së PA.</i></p> <p><b>Tema 12 -</b> Vdekja e papritur dhe ringjallja zemër-mushkëri. <i>Etiologjia e vdekjes së papritur dhe reanimimi zemër-mushkëri, si procedura mjekësore mjaft efektive në praktikën klinike në rastet e vdekjeve të papritura. Elementët e kësaj procedure dhe veprimet që kryhen.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<p><i>fq 71-83</i></p> <p><i>fq 84-98</i></p> <p><i>fq 108-110</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>	
	V.	<p><b>Tema 13 –</b> Cor pulmonar kronik <i>Sindromi klinik ku dëmtimet në zemër janë sekondare dhe vijnë si pasojë e sëmundjeve kronike të parenkimës pulmonare, vazave, pleurës apo dëmtimeve të toraksit. Etiologjia, klinika që manifeston pacienti dhe trajtimi. Roli i kujdesit infermieror në këtë patologji.</i></p> <p><b>Tema 14 -</b> Sëmundjet e perikardit. Perikarditi akut. <i>Infamacioni i cipave të perikardit me shkaqe të shumëllojshme. Klasifikimi i perikarditeve në bazë të tipit, kohëzgjatjes, ecurisë klinike. Simptomat e sëmundjes dhe mjekimi. Roli i kujdesit infermieror në këtë patologji.</i></p> <p><b>Tema 15 -</b> Tamponada e zemrës. <i>Ndërlikim i perikarditit eksudativ dhe roli i ndërhyrjes infermiore në këtë patologji.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<p><i>fq117-120</i></p> <p><i>fq 48-49</i></p> <p><i>Fq 50-51</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
		VI.	<p><b>Tema 16 -</b> Ethja reumatizmale. <i>Shkaktarët e patologjisë, simptomatologjia klinike, kriteret diagnostikuese dhe trajtimi i pacientëve me këtë patologji. Kujdesi infermieristik në të sëmurët me ethe reumatizmale.</i></p> <p><b>Tema 17 -</b> Kolapsi, shoku dhe sinkopet. <i>Simptomat klinike që manifeston pacienti dhe asistenca infermiore në këto situata klinike që kërcënojnë jetën e të sëmurit.</i></p> <p><b>Tema 18 -</b> Insuficiencia kardiake.</p>	<p><i>fq 23-26</i></p> <p><i>fq 115-116</i></p> <p><i>fq 121-126</i></p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Paaftësia e zembrës për të pompuar debitin e përshtatshëm të gjakut për nevojat indore. Stadet e IK sipas NYHA. Etiologjia e IK, klinika që shfaq pacienti në këtë rast. Menaxhimi terapeutik dhe kujdesi infermieror në pacientë me IK.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>		<i>Praktikë 4 orë</i>
VII.	<p><b>Tema 19</b> - Çrregullimet e ritmit sinusal, atrial, ventrikular.  <i>Takikardia sinusale, Bradikardia sinusale, Ekstrasistolat, Takikarditë paroksizmale, Fibrilacioni atrial dhe flateri atrial.</i>  <i>Simptomat klinike në secilin çrregullim të ritmit, mjekimi.</i></p>	<i>fq 99-110</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 20</b> - Çrregullimet e përcimit. Blloku sinoatrial.  <i>Etiologjia në këtë patologji dhe ndryshimet në EKG.</i></p>	<i>fq 111-112</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 21</b> - Blloku atrio-ventrikular.  <i>Klasifikimi i BAV sipas gradëve dhe ndryshimet që konstatohen në EKG e këtyre pacientëve. Mjekimi i crregullimeve të përcimit dhe roli i kujdesit infermieristik në to.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<i>fq 112-116</i>	Leksion 1 orë
VIII.	<p><b>Tema 22</b> - Astma kardiake dhe edema pulmonare akute.  <i>Dy situata klinike që janë të ngjashme nga etiologjia dhe paraqitja klinike, por edema pulmonare akute është lehtësisht situatë klinike më e rënduar.</i>  <i>Etiologjia, simptomat klinike, mjekimi dhe roli i veçantë që ka infermieri me përkujdesjen e tij në këto dy patologji.</i></p>	<i>fq 127-130</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 23</b> - Semiotika klinike e aparatit respirator. Vlerësimi laboratorik, instrumental dhe radiologjik i aparatit respirator.  <i>Simptomat klinike që manifestohen në patologjitë respiratore, roli i spirometrisë dhe parametrat që ajo monitoron.</i></p>	<i>fq 131-137</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 24</b> - Astma Bronkiale.  <i>Përkufizimi i sotëm rreth astmës bronkiale. Format e saj etiopatogjenetike, simptomatologjia klinike, diagnoza dhe trajtimi. Drejtimet e terapisë së astmës. Ndërlikimet dhe kujdesi infermieristik në këtë patologji.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<i>fq 212-218</i>	Leksion 1 orë
IX.	<p><b>Tema 25</b> - Pneumopatitë obstruktive kronike  <i>Shkaqet kryesorë të këtij grupi janë astma bronkiale, bronkiti kronik dhe emfizema pulmonare. Tabloja klinike e pneumopative obstruktive dhe menaxhimi terapeutik i tyre që është i gjerë dhe kompleks.</i></p>	<i>fq 153-155</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 26</b> - Bronhektazia.  <i>Sëmundje kronike e mushkërive, me zgjerim jonormal të bronkeve, me kollë kronike dhe sekrecione në aspektin klinik. Klasifikimi i bronhektazisë, simptomat dhe mjekimi. Kujdesi infermieristik në të sëmurët me bronhektazi.</i></p>	<i>fq 144-148</i>	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 27</b> - Abscesi i mushkërive  <i>Proces supurativo-nekrotik që karakterizohet nga formimi i një kaviteti të rrethuar me një kapsulë dhe përreth me një reaksion perifokal. Etiologjia,</i></p>	<i>fq 149-152</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies	
	<p><i>simptomat klinike, mjekimi dhe ndërlikimet e sëmundjes. Roli i përkujdesjes infermierore në këtë patologji.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>		<i>Praktikë 4 orë</i>	
X.	<p><b>Tema 28</b> - Sëmundjet e pleurës. <i>Pleuritet, klasifikimi i tyre, etiologjia sipas llojit të pleuritit, klinika dhe mjekimi. Teknika e punksonit pleural. Kujdesi infermieristik në të sëmurë me pleurite.</i></p> <p><b>Tema 29</b> - Infeksionet e sistemit respirator. Bronkiti akut. <i>Simptomat klinike të bronkitit akut, shkaqet infektive, fiziko-kimike dhe alergjike. Mjekimi i bronkitit sipas shkakut dhe kujdesi infermieristik në bronkitet akute.</i></p> <p><b>Tema 30</b> - Pneumonitë. Pneumonia akute. <i>Simptomat klinike të kësaj patologjie dhe stadet klinike nëpër të cilat ajo kalon gjatë ecurisë së saj. Mjekimi dhe ndërlikimet që mund të shoqërojnë pneumoninë akute. Kujdesi infermieristik në të sëmurë me pneumoni akute.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<p><i>fq 159-162</i></p> <p><i>fq 138-139</i></p> <p><i>fq 168-172</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>	
	XI.	<p><b>Tema 31</b> - Tuberkulozi pulmonar <i>TBC primar dhe ai sekondar, simptomat klinike. TBC kavernoze, fokal e infiltrativ. Simptomat klinike sipas formës dhe parimet e mjekimit të tuberkulozit. Kujdesi infermieror në pacientët me TBC.</i></p> <p><b>Tema 32</b> - Sëmundjet vaskulare pulmonare. Embolia pulmonare. <i>TEP si një patologji e rëndë dhe jetëkërcënuese, faktorët që favorizojnë formimin e trombeve, klinika dhe trajtimi i këtyre pacientëve. Roli i kujdesit të infermierit në këtë patologji.</i></p> <p><b>Tema 33</b> - Infarkti pulmonar. <i>Pasojë e mbylljes së degëve të arteries pulmonare, sidomos në fushat e poshtme pulmonare. Shenjat klinike në këtë patologji. Mjekimi i menjëhershëm ka vlerë në shpëtimin e jetës së pacientëve me këtë patologji.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.</p>	<p><i>fq 182-190</i></p> <p><i>fq 177-178</i></p> <p><i>fq 178-181</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
		XII.	<p><b>Tema 34</b> - Pneumotoraksi <i>Prania e ajrit në hapësirën pleurale. Llojet e PNX sipas etiologjisë dhe klinika që manifeston. Mjekimi dhe kujdesi infermieristik në pacientët me pneumotoraks.</i></p> <p><b>Tema 35</b> - Bronkiktet kronike <i>Sëmundja më e përhapur e aparatit respirator, e cila zgjat me vite, me periudha acarimi dhe qetësimi. Etiologjia, simptomat klinike dhe trajtimi i kësaj patologjie. Ndërlikimet e bronkiveve kronike dhe kujdesi infermieror te këta pacientë.</i></p> <p><b>Tema 36</b> - Tumoret pulmonare. <i>Kanceri pulmonar si një patologji malinje me prognozë përgjithësisht të varfër. Faktorët etiologjikë, simptomat që shfaq kanceri i mushkërive, metodat diagnostikuese dhe trajtimi i vështirë i kësaj patologjie.</i></p>	<p><i>fq 164-167</i></p> <p><i>fq140-144</i></p> <p><i>fq 156-158</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XIII.	<b>Tema 37 - Artriti Reumatoid</b> <i>Etiopatogjeneza e sëmundjes. Shenjat klinike dhe ndërlikimet e AR. Kriteret diagnostike dhe mënyra e trajtimit të pacientëve me artrit reumatoid. Ku konstaton kujdesi infermieror për pacientët me këtë patologji.</i>	<i>fq 221-225</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 38 - Lupusi Eritematoz Sistemik</b> <i>Patologji e indit lidhor me karakter sistemik, që prek në të njëjtëkohë shumë sisteme apo organe të organizmit. Shenjat klinike të sëmundjes sipas organit të prekur. Kriteret diagnostike dhe mjekimi patogjenetik dhe i ndërlikimeve të LES.</i>	<i>fq 226-231</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 39 - Sklerodermia</b> <i>Etiopatogjeneza dhe simptomat klinike të sëmundjes me prekje të disa organeve. Mjekimi i sklerodermisë.</i>	<i>fq 232-234</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Patologjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XIV.	<b>Tema 40 - Vaskulitet. Panarteriti Nodoz</b> <i>PAN si një sëmundje multisistemike që karakterizohet nga procese inflamatorë të përgjithësuara të enëve të gjakut, duke cuar në nekrozë të tyre. Patogjeneza, klinika, prognoza dhe të dhënat laboratorike të sëmundjes. Mjekimi dhe kujdesi infermieror në PAN.</i>	<i>fq 239-243</i>	Leksion 1 orë
	<b>GERONTOLOGJIA DHE GERIARTRIA</b> <b>Tema 41 - Geriatria dhe Gerontologjia</b> <i>Gerontologjia është shkenca që merret me procesin e plakjes fiziologjike, biologjike, duke vlerësuar ndryshimet që ndodhin në parametrat anatomo-fiziologjik.</i> <i>Geriatria është ajo shkencë mjekësore që merret me parandalimin, zbulimin dhe mjekimin e sëmundjeve në moshat e tretat.</i>	<i>fq 5-15</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 42 – Sëmundjet e aparatit respirator në moshat e tretat.</b> <i>Këto janë patologji që zënë një vend parësor në moshat e tretat. Kjo frekuencë e shpeshtë lidhet me disa faktorë. Njohja me simptomat klinike dhe mënyrat e trajtimit të këtyre patologjive.</i>	<i>fq 60-67</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> rreth sëmundjeve kryesore që prekin pacientët e moshës së tretë dhe mënyra e trajtimit në këtë rast.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XV.	<b>Tema 43 - Sëmundjet reumatizmale në moshat e tretat.</b> <i>Njohja me disa nga patologjitë kryesore të sistemit osteoartikular si: artritet, arthrozat, osteoporoza. Si manifestohen këto sëmundje në moshat e tretat.</i>	<i>fq 91-95</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 44 - Plakja aktive. ACTIVE AGING</b> <i>Të plakesh në mënyrë aktive është ajo që këshillohet sot dhe përfshin një jetë aktive mendërisht dhe fizikisht, të ndihesh i dobishëm për veten, familjen dhe shoqërinë. Plakja aktive shpesh mjaft probleme që mund të shfaqen te personat e moshës së tretë.</i>	<i>fq 24-28</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI VLORË”**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënie
	<b>Tema 45 - Personaliteti i të moshuarit dhe AGEISMI.</b> <i>Ageismi është dukuria që lidhet me diskriminimin e pacientëve të moshuar dhe në bashkëveprimin m jek-pacient kërkohet pikërisht që të rritet kujdesi shëndetësor ndaj kësaj grupmoshe</i> <b>Praktikë mësimore</b> në rreth kujdesit shëndetësor që ofrohet në moshat e treta dhe fenomenet psikologjike dhe shëndetësore me të cilat përballen personat e moshuar.	Fq 29-33	Leksion 1 orë      Praktikë 4 orë

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE											
FREKUENTIMI:		Kërkohet një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.									
KONTROLI I VAZHDUESHËM	Forma e vlerësimit	Koha e vlerësimit	Temat mësimore që do vlerësohen	Pikët maksimale	Forma e testimit të njohurive	Përmbajtja e testimit					
	Provim i pjesshem	Java7-8	1-15	30 pike	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz					
	Provim final	Fundi i semestrit	Gjithë lënda	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz					
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjate semestrit	-	10 pikë	Realizim teknikash infermierore	Demonstrim procedure në përkujdesjen infermierore					
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të praktikës për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstronjë në mënyrë periodike teknikat infermierore pranë pacientit me sëmundje interne të aparatit kardio-vaskular, respirator, lokomotor dhe sëmundje alergologjike.										
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:										
40- 49 pikë		50-59 pikë		60-69 pikë		70-79 pikë		80-89 pikë		90-100 pikë	
5		6		7		8		9		10	

**LITERATURA**

LITERATURA	
Literatura bazë	1. “Sëmundjet e brendshme 1” . Fejzi Alushi Ribotim 2017. (Fakulteti Shëndetit Publik- UV) ISBN 99927 942 8 3. 2. Geriartria, Cikël leksionesh te pergatitur nga literatura e ekomanuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>○ Medicina Pratica II Edicione 1984 Aldo ZANGARA.</li><li>○ Medicina Interna. Carlo ZANUSSI, G Muisean, CA. SORBINI.</li><li>○ Sëmundjet e Mushkërive. Grup autorësh. Fakulteti i Mjekësisë Tiranë.</li><li>○ Reumatologjia. Grup autorësh. Fakulteti i Mjekësisë Tiranë.</li><li>○ Nursing. Practice and Health care 2003 Suzan. M.Hinchiff</li></ul>
---------------------------------	--

<b>VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS</b>	
<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.